


- Në një piramidë me lartësi [KD], baza është drejtëkëndësh. Cili është këndi i faqes anësore (KBC) me bazën.  
A)KDA B)KBC C)KCA D)KCD
- Në një kon rrethor me rreze të bazës 1 njësi, përfutjesja formon me bazën këndin  $\alpha$ . Vëllimi i konit është:  
A) $\frac{1}{3}\pi\sin\alpha$  B) $\frac{1}{3}\pi\cos\alpha$  C) $\frac{1}{3}\pi\tan\alpha$  D) $\frac{1}{2}\pi\cot\alpha$
- Cili pohim nuk është i vërtetë për piramidën e rregullt:  
A)Lartësia bie në qendrën e bazës  
B)Baza është shumkëndësh i rregullt  
C)Faqet e piramidës janë të barabarta  
D)Brinjët anësore janë të barabarta
- Janë dhënë një sferë me rreze R dhe një kon me rreze të bazës R dhe lartësi R. Raporti i vëllimit të sferës me vëllimin e konit është:  
A) $\frac{1}{4}$  B) $\frac{3}{4}$  C) $\frac{4}{3}$  D) 4
- Baza e piramidës është trekëndësh kënddrejtë (C kënd i drejtë). KA është lartësia e piramidës. Sa trekëndësha kënddrejtë ka kjo piramidë.  
A)1 B)2 C)3 D)4
- Numri më i vogël i faqeve që mund të ketë një prizëm është  
A)4 B)5 C)6 D)8
- Një piramidë ka 10 faqe. Gjeni numrin e kulmeve  
A)10 B)12 C)15 D)20
- Një trekëndësh kënddrejtë me katete 3 dhe 4 rrotullohet rreth katetit më të madh. Sipërfaqja anësore e trupit të formuar është:  
A) $10\pi$  B) $12\pi$  C) $15\pi$  D) $20\pi$
- Në një piramidë të rregullt katërkëndore lartësia është 1 njësi dhe faqja anësore formon me bazën këndin  $45^\circ$ . Vëllimi i piramidës është:  
A) $\frac{1}{3}$  B) $\frac{2}{3}$  C) $\frac{4}{3}$  D) 1
- Në një piramidë me bazë katrore, brinja e katrorit dhe lartësia e piramidës kanë të njëjtën gjatësi 3cm. Vëllimi i kësaj piramide është:  
A) $\frac{16}{3}$  B) 27 C) 9 D) 18



- Në një piramidë katërkëndore diagonalja e bazës është 4 cm dhe brinja anësore formon këndin  $45^\circ$  me bazën. Gjeni lartësinë e piramidës.
- Jepet trekëndëshi kënddrejtë me katete a dhe b. Pika S me largesë 1 njësi nga plani i trekëndëshit është e barazlarguar nga kulmet e tij. Gjeni largesën e kësaj pike nga kulmet e trekëndëshit
- Një cilindri barabrinjës (lartësia është sa diametri i bazës) i brendashkruhet një kon me bazë në njerën bazë të cilindrit dhe kulm në bazën tjetër dhe i jashtëshkruhet një sferë. Gjeni raportin e vëllimit të sferës, cilindrit dhe të konit.
- Gjeni sa është rrezja e një sfere në të cilën numri që tregon vëllimin është i njëjtë me numrin që tregon sipërfaqen
- Nëse vëllimi i një sfere 8 fishohet, gjeni si ndryshon sipërfaqja e saj
- Baza e një piramide është trekëndësh dybrinjënjëshëm me bazë 6 cm dhe lartësi 9 cm. Brinjët anësore i kanë gjatësitë nga 13 cm. Gjeni vëllimin e saj
- Dy trekëndësha kënddrejtë dybrinjënjëshëm kanë hipotenuzen e përbashkët dhe me gjatësi a. Nëse planet e tyre janë pingule, gjeni largesën midis kulmeve.
- Jepet prizmi i drejtë (brinjët anësore pingule me bazat) me bazë trekëndësh.  $\widehat{ABC} = 2\alpha$  [AB] = [BC] = 14 cm, [BM] = [BN] = 4 cm, [A<sub>1</sub>M] = 20 cm. Plani i A<sub>1</sub>MNC<sub>1</sub> pret prizmin. Gjeni lartësinë e prizmit, vëllimin e tij, këndin që formon prerja me bazën, sipërfaqen e prerjes.
- Gjej vëllimin e konit të brendashkruar në katërfaqëshin e rregullt me brinjë me gjatësi a.
- Gjeni vëllimin e cilindrit të brendashkruar në prizmin e rregullt katërkëndor me brinjë të bazës a dhe brinjë anësore b.

